



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i Modullit: PËRKTHIM TEKNIK NË FUSHËN E EKONOMISË

(KSHK 7, Kualifikim për të nxënësit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë, në prezencë / online

Pedagogu i modullit:

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

Kohëzgjatja e programit të modullit: 30 orë

Nr. i krediteve: 3 kredite

Mënyra e zhvillimit: Trajnim i drejtpërdrejtë në prezencë / online

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Trajnimi, ka si qëllim kryesor konsolidimin e aftësive të përkthyesit në fushën e ekonomisë e turizmit, dhënien e disa njohurive më të avancuara në këto fusha, kuptimin e proceseve, ngritjen e një fjalori të qëmtuar dhe terminologjik dhe përdorimin e strukturave gjuhësore komplekse si në fushën e ekonomisë së ndërmarrjeve të vogla, strukturave mikpritëse etj., ashtu edhe në kalimin dhe përshtatjen a gjetjen e barasvlerësve në rastin e kulturës dhe qytetërimit të trevave shqipfolëse dhe atyre gjermanofolëse.

Në përfundim të trajnimit pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- ngrenë mbi baza krahasuese një fjalor të pasur terminologjik sipas temave të modullit;
- kuptojnë proceset dhe kontekstin;
- shfrytëzojnë tekstet paralele
- gjejnë barasvlerësit e duhur apo të mund të bëjnë zgjedhjet dhe zgjidhjet e duhura në rastet problematike.

OBJEKTIVAT E MODULLIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky modul synon:

- të japë njohuri bazë krahasuese në fushën e ekonomisë dhe turizmit sipas temave të modullit;
- të ofrojë njohuritë e duhura mbi nivelet e ndryshme të zbërthimit të teksteve nga fusha e ekonomi-turizmit;
- të ndihmojë në ngritjen e një fjalori bazë me terma nga fusha e ekonomisë;
- të ndihmojë në ngritjen e një fjalori bazë me terma nga fusha e turizmit;
- të prezantojë dhe ofrojë teknika dhe modele përkthimi në fushën e ekonomi-turizmit;
- të aftësojë të interesuarit në përkthimin në fushën e ekonomi-turizmit.

KONCEPTET KRYESORE:

1. Gjuha e sektorit
2. Termat më të përdorur në fushën e ekonomi-turizmit në shqipe e gjermanishte
3. Model të ndërmarrjeve akomoduese në të dy gjuhët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- | |
|---|
| <ol style="list-style-type: none">4. Dokumente tipike të fushës së ekonomi-turizmit: fletëpalosje, reklamë etj.5. Regjistrat gjuhësorë6. Çështje të përkthimit apo përshtatjes së elementëve kulturorë7. Përkthimi krijues |
|---|

MJETET DIDAKTIKE: Tekste të ndryshme, si raporte, reklama, udhërrëfyes, reportazhe etj.
Tekste mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë në fushën e turizmit, kontrata